

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“EXTRA CLEAN SERVICE” SHPK.**

*Me kete akt, sot me 29.01.2024, ne te nenshkruarit:*

- i. Z. Hasan Cakoni, i biri i Hysenit, lindur me 10/06/1958 në Baz dhe banues në Tiranë, në adresën: Njesia bashkiake Nr5, Rruga “Medar Shtylla” ND2, H.18, Tiranë, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal F80610116E, dhe*
- ii. Z. Daniel Guçe, i biri i Shkelqimit, lindur me 07/11/1987 në Gjirokaster dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga Pinari, Pallati 20, sh3, Ap19, madhor dhe me zotësi te plotë per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal I71107023B*

*ne cilesine e ortakeve, me vullnet te lire dhe te plote, nepermjet ketij dokumenti themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise dhe kete akt.*

**KREU I**

**EMERTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA, KOHEZGJATJA dhe OBJEKTI I  
AKTIVITETIT**

**Neni 1**

**Emertimi**

Shoqeria emertohet “EXTRA CLEAN SERVICE” Shpk (ne vijim referuar si “Shoqeria”).

**Neni 2**



**Forma juridike**

“EXTRA CLEAN SERVICE” Shpk, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne veçanti me dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar dhe ne perputhje me kete akt.

**Neni 3**

**Selia**

3.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Njesia Nr.5, Rruga “Todi Shkurti”, Hyrja 1 Nr pasurie 6/182 Tiranë, Shqipëri.



- 3.2 Shoqeria mund te hape dhe/ose mbylle filiale, dege, agjenci dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

#### **Neni 4**

##### **Kohezgjatja**

- 4.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqerise do te percaktohen permes vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ketij akti dhe legjislacionit ne fuqi.

#### **Neni 5**

##### **Objekti i veprimtarise se Shoqerise**

- 5.1 Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj si meposhte:
- "Veprimtari në Pastrimin dhe larje të kolltukëve, divanëve, karrigeve, tapeteve, moketeve, dysheqe, perde të holla dhe të trasha, grilave.
  - Veprimtari në shërbime lavanterie dhe hotelerie, larje dhe hekurosje për çdo lloj subjekti dhe transporti i materjaleve të pastruara.
  - Veprimtari në shërbime lavazherie për çdo lloj automjeti, pastrim dhe dizifektim i tyre.
  - Veprimtari në shërbime pastrimi dhe mirmbajtje të ambjenteve të brendshme dhe të jashteme publike dhe private në ambjente spitalore, qendra shëndetësore, struktura akomoduese, konvikte publike dhe private, qendrave tregtare, universitete, banka, bar-restorante, porte, aeroporte, terminale etj.

5.2 *Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme ose te nevojshme te lejuara nga ligji, per realizimin e objektit te Shoqerise."*



#### **KREU II**

#### **KAPITALI**

#### **Neni 6**

##### **Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10,000 (dhjete mije) Leke. Kapitali i nenshkruar perbehet nga 2 (dy) kuota ne perputhje me nenin 7 ne vijim.



2

6.2 Kapitali i Shoqerise apo cdo kontribut ne para per zmadhimin e kapitalit paguhet ne llogarine bankare te Shoqerise.

## Neni 7

### Ortaket

7.1 Ortaket e Shoqerise jane si vijon:

- *Z. Hasan Cakoni, i biri i Hysenit, lindur me 10/06/1958 në Baz dhe banues në Tiranë, në adresën: Njesia bashkiake Nr5, Rruga "Medar Shtylla" ND2, H.18, Tiranë, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal F80610116E, zoterues i 1 (nje) kuote korresponduese e 51 % (pesedhjete e nje perqind) te kapitalit, ne vleren 5,100 (pese mije e njeqind) Leke.*
- *Z. Daniel Guçe, i biri i Shkelqimit, lindur me 07/11/1987 në Gjirokaster dhe banues në Tiranë, në adresën: Rruga Pinari, Pallati 20, sh3, Ap19, madhor dhe me zotësi te plotë per te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. personal I71107023B, zoterues i 1 (nje) kuote korresponduese e 49 % (dyzet e nente perqind) te kapitalit, ne vleren 4,900 (kater mije e nenteqind) Leke.*

7.2 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne cdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe parashikohen ne ligjin shqiptar dhe kete Statut. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

7.3 Per qellim te marredhenieve te tyre me Shoqerine, adresa e ortakeve do te jete ajo e regjistruar ne regjistrin e ortakeve. Ortaket jane te detyruar te njoftojne ndryshimin e adreses se tyre. Administratori ka per detyre te mbaje dhe perditesoje kete regjister.

## Neni 8

### Kontributi i kapitalit

Kontributi i ortakeve ne kapitalin e Shoqerise mund te jete ne para ose ne natyre, si pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme apo te drejta.

## Neni 9

### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar

9.1 Kapitali i themeltar mund te zmadhohet ne çdo kohe, me nje ose me shume keste, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Ne rastin e rritjes se kapitalit, ortaket kane te drejten e perparësise per regjistrimin e kuotave ne proporcion me vleren nominale te kuotave te zoteruara ne kapitalin e shoqerise. Ne rast se ortaket refuzojne te regjistrojne kuotat e reja, ortaket e tjere te Shoqerise kan ete drejte te

regjistrojne kuotat e reja ne proporcion me vleren nominale te kuotave te zoteruara ne kapitalin e Shoqerise.

9.2 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne çdo rast, kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen minimumin e percaktuar ne ligj.

## Neni 10

### Transferimi i kuotave dhe e drejta e parablerjes

**10.1** Dispozitat e ketij neni te Statutit kane per qellim mbrojtjen e interesave te Shoqerise, unitetit te ortakeve dhe ekuilibrit te marredhenieve midis tyre dhe per kete arsye vendosen kufizimet e meposhtme, ne rastin e transferimit te kuotave.

**10.2** Kuotat jane lirisht te transferueshme; (i) midis ortakeve dhe bashkeshorteve dhe/ose femijet (ii) midis ortakeve dhe shoqerive te kontrolluara nga ortaket ose shoqerive kontrolluese te ortakeve (iii) midis ortakeve.

**10.3** Kuotat jane lirisht te transferueshme me testament ose nepermjet trashegimise ligjore nga ortaku tek bashkeshortja dhe/ose femijet (Trashegimtaret e Njohur). Ne rast se kuotat e perfituara nepermjet trashegimise, zoterohen nga me shume se nje Trashegimtar i Njohur, te drejttat e trashegimtareve te lidhura dhe qe rrjedhin nga keto kuota do te ushtrohen nga nje perfaqesues i perbashket i trashegimtareve. Ne rast se kuotat do te transferohen tek nje trashegimtar i ndryshem nga Trashegimtaret e Njohur, Shoqeria ruan te drejten te riblerje keto kuota nga trashegimtaret ne fjale me nje vlere te percaktuar nga eksperti i caktuar per kete qellim. Kjo riblerje duhet te realizohet brenda nje viti nga transferimi i kuotave tek ky trashegimtar. Ky parashikim nuk do te zbatohet ne rast se ortaket e Shoqerise me vendim unanimit pranojne si ortak te Shoqerise kete trashegimtar.

**10.4** Per cdo form te transferimit te kuotave (duke perfshire edhe transferimin pa kundershperblim) tek persona te tjera nga ata qe jane percaktuar ne piken 10.2 mesiper, per transferimin ortaket ekzistues te Shoqerise gezojne te drejten e parablerjes mbi kuotat e projektuara per t'u transferuar, ne perputhje me rregullat e cituara ne dispozitat ne vijim.

**10.5** Ortaku, qe ka per qellim te shese apo te transferoje pjesemarrjen e tij, duhet te njoftoje me leter rekomande Administratorin ne adresen e selise se Shoqerise. Njoftimi duhet te permbaje te dhenat personale te transferuesit te kuotave dhe te perfituesit te tyre, numrin e kuotave qe do te transferohen, kushtet e transferimit, duke perfshire çmimin dhe menytrat e pageses.


- 10.6 Administratori brenda 7 (shtate) ditesh nga marrja e njoftimit per transferimin, do te njoftoje ortaket e Shoqerise ne lidhje me transferimin ne fjale.
- 10.7 Ortaket, te cileve iu drejtohet njoftimi si me siper, duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per mbi pjesemarrjen se ciles i referohet njoftimi duke i derguar ortakut ofrues dhe Administratorit me leter rekomande brenda 30 (tridhjete) ditesh nga marrja e njoftimit, deklaraten e ushtrimit te se drejtes se parablerjes.
- 10.8 Ne rast se ortaket e tjere dhe ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotave te propozuar ky i fundit, apo me vleren e tregut ne rasin e transferimit te kuotave pa kundershperblim, ata do te caktojne nje ekspert per te percaktuar çmimin sipas vleres se tregut, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar. Pas njoftimit te çmimit te shitjes se kuotave te percaktuar nga eksperti, ortaket brenda 15 (pesembedhjete) ditesh duhet te njoftojne me leter rekomande Administratorin dhe ortakun transferues per interesimin e tyre te blejne kuotat me çmimin e percaktuar nga eksperti.
- 10.9 Ne rastin e ushtrimit te se drejtes se parablerjes nga ana e me shume se nje ortaku, pjesemarrja e ofruar do t'i takojte ortakeve te interesuar ne perpjestim pjesemarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqerise.
- 10.10 Nese nje ose disa nga ortaket qe kane te drejten e parablerjes nuk deshirojne apo nuk mund te ushtrojne kete te drejte, e drejta e tyre e parablerjes u kalon automatikisht dhe ne perpjestim ortakeve te tjere.
- 10.11 Nese asnje nga ortaket nuk ka per qellim te bleje pjesemarrjen e ofruar sipas menyrave dhe kushteve te pershkruara ketu, ortaku transferues do te jete i lire t'ja transferoje te gjitha pjesemarrjen bleresit te percaktuar ne njoftimin derguar ortakeve te tjere. Transferimi do te konsiderohet si i miratuar ne heshtje nese ortakut transferues nuk i paraqitet asnje njoftim per ushtrimin e te drejtes se parablerjes brenda 30 (tridhjete) ditesh, ose kur nuk eshte arritur asnje marreveshje brenda gjashtedhjete 60 (gjashtedhjete) diteve nga data e njoftimit te transferimit ne fjale nga ortaku transferues.
- 10.12 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet per te gjitha pjesemarrjen e ofruar.

### KREU III

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE

##### Neni 11



##### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve



11.1 Ne baze te legjislacionit shqiptar dhe kete Statut, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.

11.2 Vendimet per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme ose nepermjet konsultimit me shkrim:

- a) percaktimi i politikave te biznesit te Shoqerise;
- b) miratimi i ndryshimeve te Statutit;
- c) cdo ndryshim ne aktivitetin e biznesit;
- d) cdo shitje apo disponim i asetëve apo i siper marrjes apo nje pjese e tyre, konsolidimi, shkrirja ose bashkimi me ndonje shoqeri tjeter, shoqate, partneritet apo person juridik, nderprerja e biznesit ose emerimi i nje kujdestari, administratori te detyrueshem apo nje likuidatori te perkoheshem ose shperberja e shoqerise;
- e) hartimi i nje plani per bashkimin, ndarjen, shperberjen ose ndryshimin e formes juridike te shoqerise;
- f) emerimi e shkarkimi i Administratorit si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tij;
- g) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- h) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- i) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates dhe brenda gjashte muajsh nga perfundimi i vitit financiar;
- j) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- k) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- l) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit;
- m) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
- n) shperndarja e fitimeve dhe mbulimi i humbjeve;
- o) raste te tjera te percaktuara nga ligji nr. 9901/2008 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, dhe cdo ligj tjeter i aplikueshem ose nga Statuti.



## Neni 12

### Perfaqesimi dhe Kuorumi

- 12.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme dhe te votoje sipas kuotave qe zoteron ne kapitalin e nenshkruar e te shlyer te Shoqerise.
- 12.2 Ortaket mund te perfaqesohen ne Asamblene e Pergjithshme nga nje ortak tjetër apo nje person i trete i autorizuar nepermjet prokures me shkrim.
- 12.3 Perveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, ne rastin e vendimmarjes kur kerkohet nje shumice e thjeshte, Asambleja e Pergjithshme vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 30% (tridhjetë perqind) te numrit total te votave. Ne rastin kur kerkohet nje shumice e cilesuar, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendim nese anetaret kane me shume se gjysmen e numrit total te votave qe marrin pjese ne votim.
- 12.4 Ne lidhje me rritjen apo zvogelimin e kapitalit, Asambleja e Pergjithshme e ortakeve eshte mbledhur rregullisht kur jane te pranishem me shume se gjysma e numrit total te votave dhe vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave te anetareve pjesemarres ne votim.
- 12.5 Nese Asambleja e Pergjithshme e ortakeve nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuoromit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 (tridhjetë) dite, me te njejtin rend dite.

## Neni 13

### Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Asambleja e pergjithshme e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare si dhe kur kjo kerkohet me shkrim nga nje ose disa ortake qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Ne rastin e fundit nese Administratori nuk e therret asamblene brenda 15 (pesembedhjetë) ditesh nga paraqitja e kerkeses se ortakeve, ortakeve te siperpermendur kane te drejte ta therresin vete asamblene e pergjithshme te ortakeve, duke percaktuar rendin e dites, kohen dhe vendin e takimit ne perputhje me procedurat e percaktuara ne dispozitat ne vijim.
- 13.2 Gjithashtu asambleja e pergjithshme e ortakeve thirret ne rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
  - shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% (pese per qind) te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
  - shoqeria, brenda 2 (dy) viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pese per

qind) te asetëve te shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- 13.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve mbledhet në selinë e Shoqërisë apo pranë një vendi tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.
- 13.4 Mbledhja e asamblese së përgjithshme të ortakëve thirret me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar me postë të regjistruar ose faks ose nëpërmjet postës elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të tregojë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe do t'i dërgohet secilit ortak, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese. Gjithashtu, njoftimi duhet të përmbajë, edhe mënyrën e pjesëmarrjes në asambelën e ortakëve dhe/ose mënyrën e vendimmarrjes.
- 13.5 Njoftimi i mbledhjes mund të parashikojë edhe një datë të dytë për mbledhjen e asamblese në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit, në përputhje me përcaktimin në nenin 12.5 të këtij Statuti.
- 13.6 Njoftimi i mbledhjes nëpërmjet postës elektronike (e-mail), konsiderohet i marrë nga ortaket në datën/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të njoftimit të postës elektronike.
- 13.7 Njoftimi i mbledhjes i dërguar me faks, konsiderohet i marrë nga ortaket në datën/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të gjeneruar nga pajisja e faksit.
- 13.8 Asambleja e Përgjithshme e ortakëve kryesohet nga personi i emëruar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës (në vijim i quajtur "Kryetari i Mbledhjes").
- 13.9 Kryetari i Mbledhjes emëron sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes së asamblese.
- 13.10 Ortaket mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblese nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunikimit video-shkrues.
- 13.11 Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
- i. Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortaket të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarevajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
  - ii. Sekretari dhe/ose mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
  - iii. Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumentave të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
- 13.12 Mbledhja e asamblese në kushtet e përmendura në nenin 13.11 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur në vendin ku është i pranishëm Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtësi i procesverbalit, i cili bën të mundur përparimet dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
- 13.13 Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.



- 13.14 Vendimet e ortakeve te marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes te hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet te pasqyroje menyren e organizimit te mbledhjes se asamblese nese eshte kryer ne perputhje me ligjin dhe dipozitat e Statutit, te identifikojte ortaket e pranishem dhe te perfaqesuar ose ortaket qe kane votuar me shkrim, nese kuorumi i ortakeve qe kane votuar me shkrim eshte respektuar sipas Statutit dhe legjislacionit ne fuqi, si dhe nese vendimet konsiderohen te miratuara sipas votave te marra. Procesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbalit i bashkengjitet gjithashtu lista e ortakeve qe kane votuar (pervec rastit kur procesverbali eshte nenshkruar nga gjithe ortaket) si dhe njoftimi i thirrjes se asamblese te cilat mbahen ne seline e Shoqerise. Nese vendimet e marra nga ortaket duhet te depozitohen prane Regjistrat Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhena nepermjet konsultimit me shkrim do te sherbejne si dokumenta qe provojne te dhenat qe do te depozitohen ne kete regjister.
- 13.15 Ne rast se Asambleja e Pergjithshme e ortakeve nuk mund te shqyrtoje ne te njejten dite te gjitha ceshtjet qe duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do te behet te nesermen pa pasur nevoje per njoftim te metejshem.

#### KREU IV

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

#### Neni 14



#### Administrimi

14.1 Shoqeria do te administrohet nga nje ose me shume administratore. Administratori i pare i Shoqerise me afat emerimi 2 vjecar duke filluar nga data e nenshkrimt te ketij akti 29.01.2024 deri me 28.01.2026 eshte:

- **Znj. Fatmira Xheneti** lindur ne "Shtoj i Ri" Shkoder dhe banuese ne Tiranë, ne adresen: adresen: Rruga "Komuna e parisit", Hyrja 1 Ap 30 Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit elektronik nr. personal I36108055D,

14.2 Administratoret emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe emerimi i tyre mund te revokohet ne cdo kohe me nje vendim te njejte.

14.3 Administratoret jane persona fizik, pa ndonje kufizim ne lidhje me Shtetesine. Kohezgjatja e mandatit te administratoreve do te vendoset ne momentin e emerimit, por ne cdo rast nuk mund te tejkalojte afatin 5 (pese) vjecar. Pavaresisht ketij kufizimi, kohezgjatja e mandatit mund te riperterihet me ane te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.



## Neni 15

### Kompetencat e administratorit


15.1 Administratoret mund të administrojnë dhe përfaqësojnë së bashku ose veçmas nganjëri tjetri. Secili nga administratoret është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqësimin me paletë të treta, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislativin e zbatueshëm.

15.2 Kompetencat dhe detyrat e secilit Administratorë në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë do të përfshijnë si mëposhtë, por nuk do të kufizohen në:

- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislativin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
- iii. kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
- iv. mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabel dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
- v. përfaqësimin e Shoqërisë me paletë të treta;
- vi. kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkojnë nga legjislativi në fuqi;
- vii. mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kur e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- viii. përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përmbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek asambleja e përgjithshme, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- ix. të punësojë ose të ndërprejë marrëdhëniet e punës e punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
- x. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë akt;

15.3 Administratoret mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky akt janë të rezervuara për Asamblenë e Përgjithshme ose kufizohen nga ky akt apo legjislativi i zbatueshëm.

15.4 Është e drejtë e administratorëve të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kompetencat e tyre, tek persona të tjerë.



## Neni 16

### Eksperti kontabel i autorizuar

Nese kerkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Pergjithshme, kontrolli i pasqyrave financiare dhe te dhenave kontabel te Shoqerise do t'i besohet nje ose me shume eksperteve kontabel te autorizuar.

## KREU V

### VITI USHTRIMOR, PRISHJA dhe LIKUIDIMI I SHOQERISE

## Neni 17

### Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

- 15.1 Viti ushtrimor i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti.
- 15.2 Viti i pare ushtrimor do te filloje ditën e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe do te mbaroje me 31 Dhjetor 2024.
- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar, nese ka nje te tille, miratohen nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14 Prill 2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
- 15.4 Miratimi i dokumenteve ne lidhje me pasqyrat financiare do te kryhet çdo vit, brenda gjashte (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

## Neni 18


### Prishja dhe likuidimi i Shoqerise

- 18.1 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me proceduren e likuidimit te saj.
- 18.2 Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje ose me shume likuidator, dhe percaktoje tagrat e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 18.3 Shoqeria vazhdon te ekzistojë si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi. Gjate likuidimit togefjaleshi "*ne likuidim e siper*" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.

## Neni 19

### Ligji i zbatueshem dhe zgjidhja e mosmarreshjeve

- 19.1 Ky akt bazohet ne legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmeria dhe zbatimi i tij, duhet te kryhen ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Persa nuk parashikohet ne kete akt do te



zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.


19.2 Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij akti, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tiranes.

*Ky akt perpilohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.*

## ORTAKET

**Z.Hasan Cakoni**

(nenshkrimi)

Hasan Cakoni  


**Z.Daniel Guçe**

(nenshkrimi)

Daniel Guçe  
